

## **NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit Z.B. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr. 1396/17 të datës 28.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimi kryesor më dt. 25.01.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri **Z.B.** nga babai N. dhe nëna F. – e lindur M., i lindur më dt. ... në fsh. ...,kom. e ..., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, punon si taksist në komunën e Gjilanit, i gjendjes së varfër ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse më dt. 28.07.2017 rreth orës 22:15 minuta në ..., në rr. “ ... nga qendra e qytetit në drejtim të rrugës së ..., përballë hyrjes së Spitalit Regjional, duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës ” ... ” me ngjyrë të kaltër dhe targa të regjistrimit ... ka shkelur paragrafin 1 të nenit 149 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që nuk i është përmbajtur dispozitave të lartpërmendura të ligjit në fjalë që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit sipas të cilit “gjatë afrimit të vendkalimit për këmbësorë, shoferi i mjetit duhet të ketë kujdes të shtuar dhe t’i jap përparësi këmbësorit i cili është në vendkalim ose hyn në të” lehtë ka menduar se edhe përkundër këtyre lëshimeve nuk do të shkaktoj pasojë të ndaluar, ashtu që me të arritur në vendin e përmendur e për shkak të pakujdesisë me kohë nuk ka mundur ta ndal automjetin të cilin po e ngiste dhe për pasojë me pjesën e parë të anës së majtë godet në këmbën e majtë këmbësoren – tani të dëmtuarën Sh.B. nga fsh. ..., kom. e ..., e cila ishte duke e kaluar rrugën në vendkalimin e shënuar për këmbësor nga ana e majtë në të djathtë kundrejt drejtimit të lëvizjes, me ç’rast të njëjtës i shkakton lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjeve dhe indeve të këmbës së majtë, me pasojë të përkohshme për shëndetin.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr. 6 lidhur me paragr. 1 të KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 17, 23,51,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 365, 461,463 KPPK të pandehurit i shqipton

## **DËNIM ME KUSHT**

*Të pandehurit i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3(tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një viti nuk kryen tjetër veprë penale, në të kundërtën dënimi me gjobë ka për t'u revokuar.*

*E dëmtuara Sh.B. nga fsh. ... për realizimin e kërkesës pronëso- juridike është udhëzuar në kontestin civil.*

*I akuzuari obligohet që të paguaj paushalin gjyqsësor në shumë prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën kundër të pandehurit Z.B. nga fsh. ..., kom. e ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK.*

*Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 25.01.2018 në të cilën është bërë leximi i aktakuzës PP.nr. 1396/2017 të dt. 28.08.2017 dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri Z.B. ka deklaruarës e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale. Në mbrojtjen e tij më tej deklaroi se është vozitës profesionist qysh para 40 viteve dhe se nuk ka pasur kurrfarë problemi në komunikacion dhe se pendohet thellë për rastin që i ka ndodhur, se e dëmtuara ka pësuar lëndime të vogla dhe nuk ka dashur të shkoj te mjeku, por megjithatë, i akuzuari ka insistuar dhe e ka dërguar në spital. Disa herë e ka kontaktuar me telefon të dëmtuarën për ta pyetur se si është me shëndet e cila i është përgjigjur se gjithçka është në rregull.*

*Në seancën fillestare gjykatësja individuale mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që konstatoi se për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja individuale konstatoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit, pranim është i bazuar në faktet lëndore të cilat i përmban aktakuza se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.*

*Konform kësaj, gjykatësja individuale vërtetoi gjendjen faktike si vijon: i akuzuari Z.B. ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr. 1 KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të Aktgjykimit.*

*Me nenin 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 është paraparë që “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor, do të ndëshkohet sipas ligjit”.*

*Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata vendosi që të pandehurin Z.B. ta shpallë fajtor për veprën e kryer penale pasi që në veprimet e të njëjtit përmbahen të gjitha rrethanat e kësaj vepre penale dhe se për këtë vepër është penalisht përgjegjës.*

*Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjykatësja individuale mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë më llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese mori parasysh se i pandehuri është baba i tre fëmijëve dhe se deri më sot nuk ka qenë i gjykuar. Nga rrethanat rënduese mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe faktin se kjo vepër është mjaft e shpeshtë në komunikacion.*

*Sipas bindjes së gjyqtarës individuale dënimi me kusht i shqiptuar kundër të pandehurit Z.B. paraqet një dënim të drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë për të pandehurin.*

*Gjykatësja individuale konstatoi se edhe me dënimin e tillë mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 të KPRK që i pandehuri në të ardhmen mos të kryej vepra penale, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.*

*Duke pasur parasysh natyrën e kësaj vepre penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykatësja në bazë të nenit 451 paragr. 1 KPPK, vendosi që të pandehurin ta obligoj që të paguaj vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

*Në bazë të cekurave të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.*

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

**P.nr.874/2017 më dt. 25.01.2018**

**Sekretarja juridike,**  
Suzana Kovaçević

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
Snezhana Mihajloviq

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

**Përktheu –**  
Naile Keçmezi



